



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 13 QERSHOR 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 13. JUNA 2013. GODINE**

**QERSHOR - JUN
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregtinë e mallrave strategjike,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produktet e ndërtimit,
6. Zgjedhja e një anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Prvo razmatranje Nacrt zakona o trgovini strateških roba,
5. Drugo razmatranje Nacrt zakona o građevinskim proizvodima,
6. Izbor jednog člana Nezavisne komisije za medije.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

Të nderuar deputetë,

I hap punime e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Kryesia, në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përcaktuar nejtë, këto dihen.

1. Deklarime jashtë rendit të ditës

Siç e dini, të gjithë i dini rregullat, sa zgjat diskutimi, sa nuk zgjat... Fillojmë me diskutimet.

Fjalën e ka Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuara deputete dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Unë e kërkoja fjalën sot për të shprehur shqetësimin për mungesën e ujit në kryeqytet.

Do të thotë, ka dy ditë që kryeqyteti po përballet me mungesë të ujit. Për më tepër, gjysma e kryeqytetit po përballet me mungesë të artikullit esencial që është uji. Kjo ka irrituar në masë të madhe qytetarët e Prishtinës dhe është esenciale, që Komuna e Prishtinës, kryetari i Komunës së Prishtinës, zoti Isa Mustafa, para çdo projekti tjetër të investojë dhe të sigurojë ujin e pijshëm. Prandaj, është kërkesë e të gjithë qytetarëve të Prishtinës, që Komuna të ofrojë përgjegjësi sot për këtë mungesë dyditore, e cila po vazhdon edhe tash. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Veç për njohuri të deputetes së nderuar. Unë nuk e di edhe mbas 14 vjet në liri, disa deputetë nuk e dinë që kompania e ujësjellësit nuk është kompani komunale, por është regjionale.

Dhe, mos flisni gjëra që s'i dini. Dhe, atë realisht e menaxhon edhe Ministria e Financave, atje i marrin paratë, domethënë, është kompani regjionale. Lëreni Isa Mustafën, kryetarin e Komunës, sepse nuk është përgjegjësi e tij kjo. Ai është kryetar komune, por kjo është kompani regjionale. Kuptojeni këtë punë dhe mos i shfrytëzoni situatat, kur qytetarët, se edhe ne jemi qytetarë të Prishtinës, e kemi këtë problem kur s'kemi ujë, por nuk është përgjegjësi e Komunës.

Ta dini, që po ndërtohet edhe një fabrikë e ujit në Shkabaj, që nuk po ndërtohet prej Komunës, merr pjesë Komuna, po ka edhe donacione, ndihmon edhe Qeveria. Prandaj, diferenconi gjërat dhe ju lus, mos bëni marketing pa nevojë, sepse këto nuk qëndrojnë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues! Në emër të Grupit e kam fjalën.

Komisioni për Legjislacion i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për dy ditë radhazi diskutoi në lidhje me Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Ky komision është përgjegjës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë të çfarëdo vendimi, apo projektligji pranë tij. Në po këto dy mbledhje të Komisionit, anëtarët e Komisionit nuk u ndalën te vlerësimi i kushtetutshmërisë në lidhje me këtë projektligj, as në përgjithësi, e as në hollësi.

Pyetjet themelore në lidhje me këtë do të ishin:

- A është kushtetues themelimi i Asociacionit serb në Republikën tonë, që është në fakt krijimi i strukturës paralele në nivel shtetëror?
- A është kushtetues krijimi i Fondit zhvillimor për veriun i ndarë nga Buxheti i shtetit?
- A është kushtetuese që Gjykata e Apelit në veri t'i trajtojë rastet vetëm të një etnie, pra serbëve?
- A është kushtetuese amnistomi i kriminelëve, pra imunizimi i tyre nga ndjekja penale?
- A është kushtetues organizimi i zgjedhjeve, jo nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve? Sigurisht që jo, e këtë e dini secili prej jush. Por, kjo dijeni në këto momente nuk është e përshtatshme për pozitën tuaj, me sa duket.

Është e domosdoshme, që Komisioni për Legjislacion, Kryesia, ky Kuvend ta dërgojë këtë projektligj, vendimin e Qeverisë që e solli në formën e projektligjit në Gjykatën Kushtetuese. Kështu, Gjykata Kushtetuese mund të vlerësojë me kompetencë të plotë përputhshmërinë ose jo, me parimet, frymën dhe çdo germë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Diskutimet rreth asaj se a duhet të jetë plani i zbatimit apo jo në këtë projektligj, qëndrojnë, por nuk e zbehin thelbin e kësaj marrëveshjeje të dëmshme. Plan i zbatimit rrjedh nga marrëveshje dhe si i tillë është reflektim i çështjeve të dakorduara në marrëveshje. Çdo plan zbatimi që do të rridhte prej tekstit të kësaj marrëveshjeje do të ishte njëjtë i dëmshëm.

Pra, miratimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes edhe pa planin e zbatimit, nuk na shpëton nga dëmet dhe antikushtetutshmëria e saj. Problemi zanafillor është vetë

marrëveshja. Ajo në princip na e shpërfytyron shtetin e na pamundëson të ardhmen e sovranitetit.

Çështje tjetër problematike që po vërehet në negociatat e javëve të fundit lidhet me Gjykatën Supreme, Prokurorinë e Shtetit, Këshillin Gjyqësor dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, të cilat janë institucione të pavarura të Republikës së Kosovës.

Është jashtë çdo norme kushtetuese, plotësisht e paligjshme që kjo Qeveri t'i përdorë drejtuesit e institucioneve të pavarura të Republikës së Kosovës në negociata me Serbinë.

Pjesëmarrja e këtyre në procese të këtilla politike, përbën jo vetëm tejkalim të autorizimeve të tyre ligjore e kushtetuese, por edhe precedent tepër të rrezikshëm.

Prokurori, drejtuesi i Gjykatës Supreme, drejtuesi i Këshillit Gjyqësor dhe kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk u nënshtrohen në asnjë mënyrë ekzekutivit, si dhe nuk e kanë të lejuar pjesëmarrjen në çfarëdo dimension të politikës së jashtme, sidomos aty ku po diskutohet në kundërshtim me ligjet e vendit dhe Kushtetutën që ata janë të detyruar t'i zbatojnë.

Lëvizja “Vetëvendosje”, u bën thirrje këtyre katër përfaqësuesve të institucioneve të pavarura që të refuzojnë bërjen instrument të pushtetit të padrejtë të Hashim Thaçit, në dëm të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ramadani e ka fjalën.

BURIM RAMADANI: Në emër të Grupit të Aleancës.

Faleminderit, kryesues!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Nuk ka asnjë dilemë se qytetarët e Kosovës janë evropian, por e vërteta është se Qeveria e Kosovës nuk është në nivelin evropian.

Vullneti i popullit të Kosovës për orientim kah Brukseli asnjëherë nuk është kthyer në agjendë të plotë të Qeverisë së Kosovës dhe këtu qëndron dallimi mes asaj që duan qytetarët e asaj që bëjnë qeveritarët.

Krimi i organizuar dhe korrupsioni kanë kapluar secilin nivel të qeverisjes dhe administratës në Kosovë dhe për më keq kanë kapluar mënyrën e të menduarit dhe të vepruarit të udhëheqjes politike të vendit.

Thjesht, krimi i organizuar dhe korrupsioni janë bërë pjesë e pandashme e qeverisjes në Kosovë. Tenderomania, nepotizmi, klientalizmi, militantizmi partiak, e ka mbytur qeverisjen, e ka mbytur administratën, ndërmarrjet publike e po e mbyt edhe diplomacinë.

Kjo mbi të gjitha është pengesë në rrugën tonë drejt integriteteve evropiane. Tek e fundit, Bashkimi Evropian nuk është fajtor pse ne s'kemi ujë në Kosovë, as nuk është fajtor pse ne nuk kemi sistem të mirë shëndetësor, sistem të mirë arsimor.

Qytetarët e Kosovës sot janë më të izoluarit në Evropë, regjimi i vizave vazhdon t'i bllokojë mundësitë e tyre, derisa kjo është detyrë e shpejtë e Qeverisë së Kosovës. Edhe liberalizimi i vizave, edhe integritet evropiane e kanë vetëm një adresë, këta që po na qeverisin.

Koalicioni qeverisës na e premtoi Kosovën evropiane e në vend të kësaj na solli anarkinë e Afrikës, rryshfetin allaturka, mentalitetin oligarkik të Rusisë e Kaukazit, mungesën e ligjshmërisë më keq se në krejt rajonin, e për më keq, i rriti rrymat ekstremiste e të frymëzuara nga shembujt më të këqij të Lindjes së Mesme. Kjo është Qeveria e Kosovës, ky është koalicioni për Kosovën evropiane.

Nga ky koalicion qeverisës mund të dëgjojmë gjithçka, mund të dëgjojmë edhe përralla me mbret, por jo demokraci, jo sundim të ligjit, jo zhvillim.

Kryeministri Thaçi na thoshte se në Kosovë do ta bëjë “luginën e silikonit” luginë u bë, por luginë e ekstremizmave.

Tek e fundit, një deputet i këtij koalicioni për Kosovën evropiane, doli edhe pa pikë turpi tha se Skënderbeu nuk qenka hero kombëtar i shqiptarëve. E ky është pjesë e koalicionit qeveritar, ky është pjesë e Qeverisë dhe kjo Qeveri nuk u distancua prej këtij interpretimi.

Dhe kur e dëgjoja këtë deputet, mu kujtua reklama shumë e shtrenjtë e paguar prej taksave tona 5.5 milionë euro “Kosovo the young europeans” - “Kosova evropianët e rinj”.

Duhet t'ju them tepër hapur se Kosova evropiane nuk bëhet kështu dhe nuk bëhet me ju, as nuk hiqen vizat, as nuk zhvillohet ekonomia, as nuk vendoset rendi e ligji.

Kosova evropiane nuk bëhet me këtë Qeveri. Kjo Qeveri është e kundërta e asaj që kërkojnë qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kelmendi, jo replikë veç, por për diskutim. Për replikë s'ta kam dhënë fjalën, por në emër të Grupit, apo si përfaqësues i Grupit.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Padyshim që shqetësim dhe brengë e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës është edhe korrupsioni, por nuk mund ta akuzojmë drejtpërdrejt vetëm Qeverinë aktuale, por përgjegjësi në korrupsion kanë të gjithë qytetarët dhe deputeti sapo e përmendi edhe më herët, vetë ka qenë edhe pjesë e Qeverisë, edhe vetë bën pjesë në përgjegjësinë e korrupsionit që është aktualizuar në Kosovë dhe fill pas lufte ka arritur përmasa të mëdha dhe do t'ia tregoj një të dhënë ngase jam nga Peja, ndërsa deputeti është nga Suhareka.

I nderuar deputet Ramadani,

Unë vi nga Peja, qyteti i Pejës, i posa dalë pas luftës. Dhe ju përmendët shumë terma ofenduese edhe në drejtim të Qeverisë edhe të qytetarëve të Republikës së Kosovës, por të gjithë ata që ti i përmende, po ta jap një informatë.

Unë e di qëllimin se deshe ta përqendrosh opinionin tjetërkah, por ata që ti i përmende dhe Qeveria aktuale nuk akuzohet në Pejë dhe Rrafsh të Dukagjinit për vrasjen e shumë qytetarëve të saj pas luftës. Të gjithë ata që ti i përmende asnjëri s'ka të bëjë me kidnapimet dhe rrëmbimet e qytetarëve në qytetin e Pejës. Të gjithë ata që i përmende ti as nuk janë të akuzuar për vrasje politike dhe haraç dhe tenderë bizneseve dhe qytetarëve të Pejës. Ti e din mirë për kë e kam fjalën.

E apostrofove edhe deklaratën time sa i përket heroit kombëtar, Skënderbeut. Gëzim Kelmendi, nuk ka përmendur ashtu, është përgjegjësi e mediave që e kanë apostrofuat deklaratën time, por kam ngritur dilemë si deputet dhe i Parlamentit të Kosovës, ngase kemi shumë divergjenca mes historianëve vendorë dhe ndërkombëtarë. Njëra palë apostrofohet se është hero i krishterimit, ndërsa tjetra- hero kombëtar. Kjo është dilema ime si qytetar i Kosovës, ngase edhe një informatë që ndoshta që nuk e ke ditur, por e kam përmendur në debate televizive. Në tekstet tona shkollore fyhet rënd identiteti i besimtarëve të ndryshëm, por edhe i besimtarëve islamë, kur ceket se shtyllë e pestë e islamit është lufta ndaj të pafeve. Për këtë duhet të japin përgjegjësi ata historianë që e kanë futur këtë term, ngase i nxisin qytetarët e Kosovës për luftë ndaj të pafeve. Prandaj, dilema ime si deputet i Kuvendit të Kosovës është kush është në të vërtetë, le të hapet temë mes akademikëve profesionistë historianë shkencorë se çka në të vërtetë ka paraqitur historia e Skënderbeut dhe nuk është qëndrim i Gëzim Kelmendit, sepse Gëzim Kelmendi nuk është profesionist. Faleminderit!

KRYESUESI: Tu kisha lutur që këtë temë mos ta fusësh më në Parlamentin e Kosovës dhe vërtet je deputet dhe ne e kemi një histori, s'ka nevojë që ne ta diskutojmë pas 500 vjetëve historinë, sepse dikush mund të thotë a jemi shqiptarë a s'jemi shqiptarë, nesër? Zoti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Është vështirë të jesh indiferent ndaj këtyre temave shumë të ndjeshme, por unë kam dy shqetësime nga komuna e Malishevës dhe nuk mund t'i tejkaloj e të futem në debatet që janë aktuale.

Kemi problemin e parë, ethet hemorragjike që këto ditë kanë marrë një jetë të qytetarit të Malishevës dhe kërkoj nga Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me komunën e Malishevës të bëjnë të pamundur që të bëjnë të gjitha veprimet që kërkohen shkencërisht në spërkatjen e territorit, të hapësirave dhe krejt çka është e nevojshme.

Dy. Kam një shqetësim tjetër. Në aksin rrugor, nga Gjergjica për në Pejë fillon tash zgjerimi i rrugës dhe kemi pakënaqësi të qytetarëve të cilët kanë dalë në rrugë dhe kanë demonstruar e kanë shprehur pakënaqësitë e tyre.

Unë, si përfaqësues i atyre kërkoj nga Qeveria që t'i marrë në konsideratë të gjitha pretendimet e komunitetit të biznesit dhe të gjithë atyre që mbajnë gjallë familjet, qytetarët e punësuar dhe të marrin në konsideratë e të përshtatin vijën e rrugës adekuat me nevojat të cilat ata i ngrisin me shqetësim të jashtëzakonshëm.

Kanë bërë investime jashtëzakonisht të mëdha në pronat e tyre në vijën aktuale të asfaltit dhe natyrisht që Qeveria, tash këtë rrugë, duhet ta përshtatë aty ku është e mundur dhe sa të jetë e mundur.

Nëse këtë do ta bëjë edhe qytetarët edhe unë do t'i falënderohemi Qeverisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Ferati e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë,

Unë sot do të ngris një çështje që për një kohë të gjatë do të jetë shqetësim në Kosovë e kjo është politizimi i administratës. Të gjithë e dimë se kjo nuk është veti veç e një institucioni, por gati e ka përfshirë gjithë Kosovën. Megjithatë, unë dua të bëj një thirrje që të përqendrohen institucionet e Republikës së Kosovës që kjo çështje të mos marrë përmasa alarmante çfarë ka filluar.

Si shkas që të diskutoj sot është një ndodhi që ka ndodhur në komunën e Mitrovicës edhe pse atje administrata diku rreth 80% është e partisë në pushtet, por si po shihet, kanë vendosur t'i thyjnë rekordet botërore si edhe në 1946 deri në 1956, përqindja më e madhe s'u kanë. Tash ka mbërri deri në 80%, dikujt po i duket pak dhe ka shkuar zyrtar për zyrtar, asistentja e kryetarët duke iu bërë me dije në mënyrë direkt ose indirekt që po qe se s'je anëtare e nënshkruar këtu, e ke të rrezikuar vendin e punës.

Domethënë nëse 80% janë të një partie, në një mes shumë heterogjen, dhe i duket dikujt pak, unë e di që në 1946 – 1956, përqindja ka qenë më e përzier, s'ka qenë bash kështu, s'ka pas mund të dominojë as ai që i ka penguar feja as kombi.

Prandaj, mos thyeni rekorde në këtë fazë, e dimë se jemi në prag të shpalljeve të zgjedhjeve, por unë po i thërras të gjithë, pa dallime, të kemi kujdes, sepse këto deformime kur ndodhin një herë krijojnë reaksione zinxhirore, sepse, në demokraci pushtetet ndërrojnë.

Çka do të ndodhë në momentin kur bie kjo parti në pushtet, vjen tjetra? Duhet t'u japim premtime prej sot krejt prej pune keni për të dalë. Kjo pastaj është e keqe. Prandaj, nëse një të keqe nuk e ndalim sot, mos të ngritim nesër zërin se dimë t' i mbrojmë të drejtat e dikujt. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Gashi e ka fjalën.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryesues!

Si pasojë e privatizimit të egër, 76 mijë punëtorë kanë humbur vendin e punës. Këto të gjitha janë rrjedhojë e shkatërrimit të kapaciteteve prodhuese dhe ndryshimit të destinimit ekonomik të ndërmarrjeve prodhuese, por jo vetëm të tyre.

Të gjitha ndërmarrjet e privatizuara e kanë reduktuar numrin e punëtorëve në minimumin e domosdoshëm, duke rritur eksploatimin e punëtorëve, keqpërdorimin dhe shfrytëzimin e tyre.

Në mesin e këtyre është edhe gjiganti i gomës në Therandë "Ballkani" i cili u privatizua në korrik të vitit 2005, fabrikë kjo e cila, me asete shumë të pasura dhe me rreth 17 hektarë tokë, është shitur me një çmim përbuzës prej 1.4 milionë eurosh. Privatizimi u bë me spin off special dhe pronari kushtëzohej që të investonte 6 milionë euro si dhe kriter ishte punësimi i 375 punëtorëve.

Mirëpo, këto 6 milionë euro asnjëherë nuk janë investuar, numri i punëtorëve asnjëherë nuk ka qenë 375, madje ai është zvogëluar vazhdimisht për shkak të maltretimit të tyre duke punuar me orë të stërzgjatura dhe duke marrë paga jo të dinjitetshme, me mesatare prej 180 euro në muaj. Për shkak të kushteve jo të sigurta në vendin e punës, pas privatizimit, kanë humbur jetën dy punëtorë.

Në vend që të investohej e të rritej numri i punëtorëve, pronari i ri i ka shitur 'Viva Fresh'-it, 70 arë tokë për 1,5 milion euro, që i bie më shtrenjtë se që ka kushtuar i tërë gjiganti duke bërë kështu që ndërmarrja që dikur kishte rreth 1800 punëtorë, një pjesë e saj të shndërrohet në qendër tregtare, duke bërë kështu pazare përbrenda kompanisë.

Andaj, kërkesë e punëtorëve është që sa më shpejt të bëhet rishqyrtimi i privatizimit të kësaj ndërmarrjeje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Donika Kadaç-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: E pata një temë që lidhet me kompensimin e dëmeve të bujqve në Istog, por po dua ta marrë një temë tjetër.

Po dua t'i drejtohem këtij djalit që foli më herët. Për fjalët që i the, ti duhesh të japësh përgjegjësi penale dhe duhesh të thirresh si dëshmitar. Nën një.

Nën dy, ti je vetë Qeveria. Edhe ky ministri i Punëve të Brendshme që doli duhet të jetë këtu. Zbuloni krimet, jo veç në Pejë, por gjithkund tjetër. Zbuloni krejt ato çka po i thoni, sepse jeni Qeveria dhe ne po ju thërrasim t' i zbuloni. E para.

Dhe e dyta, si Qeveri duhet ta zbuloni me prioritet financimin e ekstremizmit në Kosovë dhe frymëve që ky i përfaqëson, shumë me prioritet, sepse na morët në qafë.

E treta, sa për Pejë, ku Aleanca është mbi 50%, njerëzit që e refuzojnë ndërtimin e bustit të Nënës Terezë dhe e mohojnë Skënderbeun, fatkeqësisht edhe për ta e fatmirësisht për popullin e Pejës dhe popullin e Kosovës, nuk kanë vend.

Prandaj, dikush që i bën këto veprime në Parlament, dikush që nënat e gratë e Kosovës i fyen publikisht në Parlament, nuk e ka vendin as në Kosovë e lere më me të nuk ecet në Evropë.

Edhe një herë, po e rikonfirmoj se prej asaj çka tha, kjo Qeveri me këtë koalicion nuk mund të shkojë dhe nuk do ta dërgojë asnjëherë Kosovën në Evropë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Justina Shiroka- Pula e ka fjalën.

JUSTINA SHIROKA-PULA: Faleminderit, kryesues!

Përsëndetje për kryesuesin!

Ministër,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Çështja e politikave të transmetimit përkufizohet qartë me nenin 141 të Kushtetutës së Kosovës, e cila parasheh themelimin e Komisionit të Pavarur të Medieve dhe jep autorizim që të rregullojë këtë sektor në formë të pavarur.

E autorizuar edhe me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Medieve, Komisioni prej kohësh po punon në hartimin e strategjisë për digjitalizimin, ngase është paralajmëruar se kalimi nga transmetimi analog në digjital në të gjithë Evropën do të duhet të përfundojë më 17 qershor 2015.

Kjo datë shikohet si data ndërkombëtare e obligueshme për shkyçje nga transmetimi analog së paku brenda kufijve nacional të shteteve përkatëse.

Shtetet e rajonit kanë vepruar kryesisht me një procedurë të ngjashme e kanë miratuar strategjinë e digjitalizimit që i ka paraparë të gjitha elementet në to, si koston, mënyrën e ndarjes së frekuencave, mënyrën e përzgjedhjes së operatorit të shërbimeve, e tjera, e tjera.

Në Kosovë, Komisioni i Pavarur i Mediave ka miratuar para disa muajsh një strategji jo të plotë në përmbajtje dhe me shkelje të procedurave duke mos e hedhur në diskutim publik para se ta çojë në Qeveri, për miratim. Me këtë veprim e kanë shkelur Ligjin e Komisionit të Pavarur të Medieve.

Qeveria nuk e ka miratuar strategjinë pas presioneve që është bërë nga mediet nëpërmjet të Zyrës së Zhbogarit, por e ka kthyer prapë në plotësim nga aspektet përmbajtjesore dhe financiare.

Ndërkohë, pa u miratuar strategjia e cila duhet të kishte një ligj përcjellës, krejt teknik, me ca nene për zbatimin e strategjisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik e nis procedurën për përgatitjen e Ligjit për digjitalizim.

Projektligji përmban propozime që paraqesin shkelje të përsëritura të Kushtetutës dhe të legjislacionit aktual në Kosovë.

Ky projektligj bëhet edhe më absurd, duke pasur parasysh se tenton të rregullojë vetëm fazën deri më 17 qershor 2015 e jo edhe të gjithë sferën e digjitalizimit.

Pra, esenca është që dokumenti i cili duhet të punohet është strategjia e jo ligji. Strategjia duhet të pasqyrojë koston aktuale, strategjia aktuale duhet të përmbajë Rregulloren që KPM-ja ia bën frekuencave që i kemi në dispozicion pa e dëmtuar mbulimin....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hajzeraj e ka fjalën.

RITA HAJZERAJ- BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë dua t'i ngre dy çështje. Çështja e parë ka të bëjë me Istogun, Pejën dhe Deçanin, pra pronarët e tokave apo bjeshkëve e kullosave të cilat nuk mund t'i shfrytëzojnë në kufi me Malin e Zi.

Kjo çështje është ngritur disa herë në Parlamentin e Kosovës, po asnjëherë nuk kemi marrë përgjigje nga Qeveria e Kosovës.

Këtyre disa herë u është thënë që të dy qeveritë e dy shteteve, të Kosovës dhe Malit të Zi, duhet të takohen dhe të bien në dakord për shfrytëzimin e këtyre kullosave apo bjeshkëve.

Shumica prej këtyre qytetarëve kanë edhe dëshmi se këto toka u takojnë atyre para disa vjetëve.

Unë para veti e kam një petition apo kërkesë, i cili është nënshkruar prej 77 qytetarëve të tri komunave dhe 77 qytetarë janë nga 77 familje, që do të thotë se këto familje që sa vjet bëjnë kërkesë tek Qeveria jonë dhe ende nuk e kanë gjetur përgjigjen e duhur.

Çështja e dytë ka të bëjë me të reshurat e fundit që kanë rënë në disa komuna të Kosovës, pra breshëri. Konkretisht e kam fjalën për komunën e Istogut, sepse atje më shumë se 60% e qytetarëve të Istogut jetojnë nga bujqësia dhe këto të reshura kanë bërë dëme të mëdha në bujqësi. Andaj unë kërkoj përkundër ndihmës së madhe që po jepet nga komuna e Istogut, kërkoj nga Qeveria e Kosovës, konkretisht nga Ministria e Bujqësisë, që t'u dalë në ndihmë këtyre qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,

Unë do të flas për lojërat e fatit të cilat janë përhapur sot kudo në Kosovë, nëpër lagjet e vendbanimeve, pranë shkollave, objekteve religjioze dhe institucioneve të ndryshme, pikërisht aty ku e ndalon ligji.

Ligji për lojërat e fatit e bën të qartë vijën ndarëse në mes të trajtimit si luks të kësaj veprimtarie dhe abuzimit me popullatën e varfër dhe fëmijët.

Ndërsa, përhapja e bixhozit përkundër ligjit na bën të drejtohem drejtpërdrejt nga institucioni që i licencon ato. Si është e mundur të lëshohen licenca të panumërta nga Administrata Tatimore e Kosovës për këto veprimtari, pikërisht aty ku e ndalon ligji? Ne e dimë që ATK-ja është mjaft aktive kur bëhet fjalë për bizneset e vogla e të mesme, si u bëka që të jetë e tillë, pra inkurajuese me bixhozin?

Kjo e bën të qartë lidhjen pushtet – bixhoz. Dhe a lidhet kjo vetëm ngushtë me shpëlarje parash apo me fitimet marramendëse nga hallexhinjtë e varfër apo ka edhe arsye tjera, mbetet të kuptohet kur kësaj çështje do t'i shkohej deri në fund?

Thuhet shpesh se në kohë krizash, lulëzojnë lojërat e fatit dhe kur thuhet kjo lihet të mendohet se ato po lulëzojkan vetvetiu.

Është e vërtetë se në kohë krizash lulëzojnë lojërat e fatit, por ato lulëzojnë pikërisht nga pushteti, sepse e ka nevojën për të në kohë krizash.

Nga përvojat edhe të vendeve tjera sot dhe në të kaluarën, përpos të qenit burim i fitimit dhe i shpëlarjes së parasë së pistë, lojërat e fatit janë mjet politik i pushtetit, sidomos kur ato përhapen në zonat e varfra në kohë krizash.

Pushtetet të vetëdijshme që i varfëri i palumtur e do ndryshimin dhe dëshira për ndryshim e bën atë të gatshëm të përpiqet dhe kjo situatë shpie pashmangshëm në organizim e që ky organizim i sjell atij shpresën reale dhe e cila e rrezikon pushtetin, pushteti gjen lojërat e fatit dhe i shpie ato në çdo cep të vendbanimeve me qëllim që t'u ofrohet shpresa e rrejshme për ndryshim të shpejtë të gjendjes së tyre të varfër. Dhe çka ndodh? Varfërim i mëtutjeshëm, pasurim i disave nga varfëria e disa të tjerëve dhe lumturi e përhershme për pushtetin.

Kjo dukuri shkatërron, qytetarin, shkatërron moralin e tij, shkatërron shtetin që do ta mbronte këtë qytetar dhe i lë matrapazët të paprekshëm.

Andaj është urgjente luftimi i kësaj dukurie, sado që do të mund t'i prekte drejtpërdrejt interesat e qeveritarëve.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Pas vendimit të fundit të Qeverisë së Kosovës për themelimin e dy komunave administrative në regjionin e Hasit, pakënaqësitë dhe kundërshtimet e banorëve hasjanë nuk kanë të ndalur. Logjika e themelimit të komunave me akte politike dhe për përfitime politike, është e papranueshme.

Pas këtij vendimi, i cili mendoj që para se gjithash është një papërgjegjësi politike e Qeverisë, janë shumë të shqetësuar, sidomos banorët e fshatrave Domjan, Lipovec, Kluçinë, situata veç sa është përkeqësuar edhe për vetë faktin se fshatrat e caktuara nuk dëshirojnë të jenë pjesë e njëres apo tjetres komunë.

Prandaj, me shumë të drejtë mund të themi se vendimi i Qeverisë për themelimin e dy komunave në Has, është shumë i ngutshëm dhe i pabazë.

Përfaqësuesit hasjanë deri më tash kanë kërkuar nga Qeveria e Kosovës, përkatësisht nga kryeministri që ta analizojë mirë vendimin e marrë. Madje, edhe Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e ka kundërshtuar vendimin e Qeverisë për themelimin e dy komunave në Has. Ata i janë drejtuar edhe vetë kryeministrit Thaçi, me një letër të hapur në të cilën veç tjerash thuhet, citoj:

“Ne veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dega në Has, me vëmendje të veçantë dhe shqetësim të madh jemi duke i përcjell zhvillimet rreth komunave të Hasit, në lidhje me të cilat këtu në Has, është duke u bërë debat i nxehtë, madje me përmasa përçarëse. Adresa e të gjitha këtyre është çështja e lokaliteteve dhe vendosjes së numrit të qendrave administrative, përkatësisht të komunave. Situata ka arritur deri aty sa që tashmë ka filluar edhe të humb kuptimi i vetë krahinës së Hasit, rreth së cilës ruhen shumë ngjarje dhe shumë histori.

Jemi të mendimit se ndarja e Hasit në dy komuna, duhet të ndryshohet për shkak se me ndarjen e Hasit në dy komuna, do të thellohet kufiri i ndarjes së Hasit dhe hasjanëve”, përfundon citati.

Madje, ata në fund të kësaj letre të hapur, kërkojnë nga të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës që të mos e votojnë propozimin, përkatësisht vendimin e Qeverisë për themelimin e dy komunave në Has.

Të nderuar deputetë,

A nuk është kjo politikë? Prandaj, unë mendoj se kjo më tepër tingëllon si fushatë elektorale ky vendim i Qeverisë, natyrisht se po.

Përfundimisht, konsiderojmë se krijimi i dy komunave brenda vetëm pak ditësh, siç edhe realisht ndodhi, paraqet një precedent të rrezikshëm për vetë faktin që asnjëherë nuk janë analizuar edhe arsyet, kahet zhvillimore të këtyre, por edhe vetëm për motive politike.

Në këtë kuptim mund të thuhet lirisht se është tejkaluar autoriteti i Qeverisë së Kosovës, prandaj ky vendim duhet të ndryshohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Po bëhen 13 ditë që disa ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ende janë grevë dhe gjendja e tyre dita- ditës po keqësohet.

Konsideroj se si Kuvend duhet t'i vizitojmë ata dhe t'u shprehim gatishmërinë tonë që jemi në nivel të përgjegjësisë dhe shumë shpejt Kuvendi nuk do ta neglizhojë gjendjen e fundit, e cila po mbretëron në Kosovë, që është shumë shqetësuese jo vetëm për ish-pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por për të gjithë qytetarët anëmbanë vendit.

Andaj, kërkoj mirëkuptim nga të gjithë grupet parlamentare dhe kërkoj që të bëhet një grup nga të gjitha grupet parlamentare, t'i vizitojë ata grevistë, gjendja e tyre po keqësohet dhe tashmë një nga ta veç ka kërkuar trajtim shëndetësor dhe është në gjendje të rëndë. Pra, që të mos na eskaloj situata dhe të mos kemi dëme më të mëdha, kërkoj që grupet parlamentare të përcaktojnë nga një përfaqësues nga të gjitha grupet, t'i vizitojnë ata dhe t'u afrojnë garanci që Kuvendi është në krye të detyrës dhe do të marrim përgjegjësi të cilat na takojnë si legjislacion.

Edhe një herë kisha dashur që grupet parlamentare të jenë të gatshme të bashkëpunojnë dhe brenda ditës t'i vizitojnë ata grevistë dhe të kërkohet nga ta që ta ndërpresin grevën, sepse nuk na shërben askujt asgjë nëse ndodh më e keqja deri te keqësimi i gjendjes shëndetësore të grevistëve që sot e 13 ditë janë në tendë pranë Stacionit Policor në Prishtinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Është ezauruar koha për deklarime jashtë rendit të ditës. Po e kryejmë edhe këtë pikën me pyetje përgjigje, që i kanë bërë ministrat.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Janë gjashtë pyetje. Zoti Aliu, pyetje për... nuk është këtu. Zonja Alma Lama, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Kryeministri nuk është këtu. A dëshironi ta bëni pyetjen?

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e bëra pyetjen edhe radhën e kaluar, kërkoja të di se cili është dokumenti në të cilin betohen ministrat dhe zëvendësministrat e Kosovës? Pres përgjigje nga kryeministri, sepse kam informacion që nuk ka asnjë lloj dokumenti në të cilin këta betohen në lidhje me besnikërinë që e kanë ndaj vendit dhe siç e kemi parë në seancat e kaluara kemi folur për një zëvendësministër në FSK, i cili duke mos u betuar askund si duket ka dërguar informacione në lidhje me armatimin e FSK-së në Beograd dhe prandaj është shumë e rëndësishme të dimë se ku betohen këta ministra dhe zëvendësministra, a punojnë apo jo për Republikën e Kosovës? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja, zonja Sahatqija pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Zonja Sahatqija e keni një pyetje, a po?

TEUTA SAHATQIJA: E kam marrë përgjigjen dhe nuk ka nevojë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Stojanović, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Gospodine ministre, u decentralizovanim opštinama Novobrd, Parteš, Ranilug, Klokot kao i u opštinama Gnjilane i Kosovska Kamenica građani imaju vozila sa privremenim kosovskim tablicama koje su preuzeli prošle godine.

Ovih dana ističe im registracija i treba da produže registraciju. Međutim u ovim sredinama se pojavila informacija da vlasnici vozila sa privremenim registarskim tablicama prilikom produžavanja registracije moraće da plate dodatnu akcizu i carinu.

Pitanje je: Da li je to tačno, i koliko iznosi ta akciza, ako treba da se plati?

KRYESUESI: Ministri, zoti Rexhepi e ka fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar kryesues i Kuvendit,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,

Fillimisht më lejoni të ritheksoj se në përputhje me marrëveshjen ose konkluzionet për lirinë e lëvizjes të datës 2 korrik 2011, të arritur me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, si dhe me qëllim të lehtësimit të lirisë së lëvizjes për të gjithë qytetarët e vendit, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Qeveria e Kosovës kanë qenë jashtëzakonisht fleksibil në ofrimin e mundësive për regjistrimin e veturave, madje pa paguar obligimin doganor dhe me zgjatje të afatit kohor në disa raste.

Pas përfundimit të gjitha afateve kohore, qendrat komunale të regjistrimit civil në komunat e banuara me qytetarët e komunitetit serb, kanë pranuar një numër të madh të kërkesave për regjistrim të automjeteve duke kërkuar fleksibilitet në çështjet e detyrimeve doganore.

Duke pasur informacione për keqpërdorim të qasjes të cilën ne e kemi zbatuar, ne kemi marrë vendim për të mos vazhduar tutje afat kohor aq më tepër që afati është shtyrë disa herë, si dhe janë organizuar fushatat nëpër çdo komunë për regjistrim të automjeteve ku janë ftuar të gjithë qytetarët, por jo të gjithë e kanë shfrytëzuar këtë të drejtë.

Ne kemi qenë para dileme se si të veprojmë për 2 mijë e 87 vetura të cilat kanë aplikuar. Pas skadimit të afatit me qëllim të ofrimit të mundësisë për qarkullim të këtyre automjeteve ne kemi marrë vendim për të ofruar targa të përkohshme të Republikës së Kosovës dhe brenda kësaj kuote të bëhet verifikimi i këtyre veturave në Interpol dhe tek autoritetet kompetente të Serbisë. EULEX-i ka ofruar asistencë në këtë drejtim. Librezat e këtyre 2 mijë e 87 veturave ende nuk janë verifikuar dhe ende nuk kemi konfirmime nga pala serbe për validitetin e këtyre librezave për këto vetura.

Në këtë drejtim është e pamundur regjistrimi i tyre pa verifikim. Vullneti jonë për regjistrimin e tyre ka ekzistuar siç është treguar edhe në të kaluarën, por njëkohësisht duhet të jemi shumë të kujdesshëm dhe t'i evitojmë keqpërdorimet e mundshme në këtë drejtim për çfarë ka indikacione se ekzistojnë. Vetëm t'ju them se ka pasur raste kur

formalisht blerësi ka qenë i komunitetit serb e në të vërtetë kanë qenë shqiptarë e ato automjete shumë të shtrenjta, prandaj këto janë elementet që neve na kanë detyruar të kërkojmë verifikimin, meqenëse në fund të këtij muaji kalon afati i tabelave të përkohshme, ne do të marrim edhe një vendim tjetër, i cili ndoshta do të mundësojë deri sa të na vjen lista e verifikimit, por i nënshtrohen atyre pagesave të rregullta si kanë qenë më herët.

Si nënpyetje ishte edhe çështja....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti Stojanoviq, a keni pyetje shtesë? Zotit Stojanoviq e ka fjalën.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Da damo mogućnost ministru da nam da kompletniju informaciju, ono što je još hteo.

KRYESUESI: Vazhdoni, zoti ministër!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Si nënpyetje ishte se çka bëjmë me kërkesat që janë legjitime të qytetarëve edhe të komunitetit serb të cilët kur shkojnë në Serbi, paguajnë taksa shtesë për sigurim, por edhe të Luginës së Preshevës që vijnë këtu?

Realisht, ne në fillim të këtyre bisedimeve kemi qenë që të nënshkruhet memorandumi i mirëkuptimit si me Maqedoninë dhe Shqipërinë, ku byrotë e kompanive të sigurimit i marrin përgjegjësitë, kompensimin për klientët e vet. Pala serbe e ka refuzuar fillimisht me motivacionin se ato janë nën BQK që është institucion shtetëror dhe gjatë këtyre bisedimeve këtë nivel të taksave e kanë caktuar byrotë e sigurimeve të automjeteve. Ne edhe më tutje jemi në favor që të hiqen këto taksa dhe të mbërrihet memorandumi si është me shtetet tjera që ata mos të jenë viktimë me këtë rast, mirëpo kjo nuk varet vetëm nga vullneti jonë, edhe ju si komunitet mund të kërkonin nga autoritetet e Serbisë për arsye se edhe ju jeni viktimë të atyre gjërave, të bëhet presion pozitiv dhe në atë kohë kur pala serbe janë të gatshëm edhe ne jemi të gatshëm të veprojmë.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Zonja Justina Shiroka- Pula, pyetje për ministrin Blerand Stavileci. A dëshironi ta bëni pyetjen, ministri s'është këtu.

JUSTINA SHIROKA-PULA: Faleminderit, kryesues!

Por pasi që ministri nuk është këtu, nuk e kisha bërë pyetjen, e lë për mbledhjen tjetër.

KRYESUESI: A vlen edhe për pyetjen vijuese?

JUSTINA SHIROKA-PULA: Po, njëjtë. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYESUESI: Pika e tretë e rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur më 31 maj 2013

Të shohim, kuorum nuk ka akoma, por nëse doni e marrim pauzën.

(Ndërhyrje)

Atëherë, bëjmë pauzë deri në orën 14:30. Faleminderit!

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregtinë e mallrave strategjike

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Ftoj ministren e Tregtisë dhe të Industrisë, zonjën Mimoza Kusari-Lila, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit!

I nderuari kryetar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që para jush të paraqes shkurtimisht qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për tregtinë me mallra strategjike.

Arsyeshmëria për këtë projektligj është përmirësimi i infrastrukturës ligjore, që do të mundësojë krijimin e një mjedisi më të favorshëm për funksionimin dhe zhvillimin e tregtisë me mallra strategjike.

Me Projektligjin për tregti me mallrat strategjike rregullohet eksporti, importi, transiti, transngarkesa, rieksperti, ritransferi i mallrave dhe shërbimeve strategjike.

Me këtë projektligj synohet të avancohet siguria kombëtare dhe interesat e politikës së jashtme të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, me këtë projektligj synohet të plotësohen marrëveshjet dhe zotimet ndërkombëtare lidhur me mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, si dhe mallrave tjera strategjike për qëllime komerciale dhe ushtarake, shkeljen e të drejtave të njeriut dhe për të kontribuar në angazhimet regjionale dhe ndërkombëtare të menaxhimit të tregtimit me mallra strategjike.

Ndryshimet e propozuara në Projektligjin për mallrat strategjike janë si vijon:

1. Projektligji është përgatitur në përputhje të plotë me legjislacionin më të përditësuar ndërkombëtar dhe evropian. Gjatë hartimit të këtij projektligji janë marrë për bazë dy akte juridike, Rregullorja e Këshillit Evropian nr. 428/2009 e datës 5 maj 2009 për vendosjen e një regjimi të komunitetit për kontrollin e eksporteve, transferimin, ndërmjetësimin dhe transitin e mallrave me përdorim të dyfishtë; si dhe Rregullorja e Bashkimit Evropian nr. 388/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19 prill 2012, për ndryshimin e Rregullores së Këshillit nr. 428/2009, për të vendosur një regjim të komunitetit për kontrollin e eksporteve, transferimin, ndërmjetësimin dhe kalimin transit të mallrave me përdorim të dyfishtë.

Fushëveprimtaria e projektligjit ka ndryshuar dhe është zgjeruar duke përfshirë trans ngarkesën, riekporton, ritransferin, si dhe shërbimet e ndërlidhura. Të gjitha përkufizimet dhe konceptet në këtë projektligj janë në përputhje të plotë me përkufizimet dhe konceptet e legjislacionit evropian të lartpërmendur.

Me këtë projektligj është paraparë të themelohet Komisioni për mallra strategjike dhe fushëveprimtaria e tij është zgjeruar edhe për kryerjen e detyrave të veta. Komisioni mund të kërkojë asistencë, këshilla dhe veprime tjera nga ministrinë tjera, agjencitë dhe ekspertët e fushave përkatëse.

Gjithashtu, me këtë ligj është bërë thjeshtësimi i rregullimit të procedurave për regjistrimin dhe aprovimin e licencave dhe kontrollimin strategjik të mallrave dhe kjo do të jetë më efikase dhe funksionale në praktikë. Me ligj do të rregullohen vetëm çështjet bazike sa i përket formës dhe procedurës, ndërsa çështjet detaje procedurale do të rregullohen me akte nënligjore.

Është rregulluar në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar dhe evropian për të drejtat e njeriut lëshimi i licencës për transaksione të cilat përfshijnë shtetet nën masat e ndalimit apo masat kufizuese në rastet e embargos.

Në këtë projektligj janë paraparë edhe ndëshkimet administrative dhe penale. Duke pasur parasysh rëndësinë e menaxhimit të kontrollit të mallrave strategjike me këtë ligj fuqizohet struktura për kontrollimin e mallrave strategjike dhe me këtë projektligj parashihet të themelohet Departamenti specifik për kontrollimin e mallrave strategjike.

Çështjet e licencimit parimisht do të rregullohen me këtë ligj, ndërsa në mungesë të dispozitave të këtij ligji, karakter subsidiar do të kenë dispozitat tjera ligjore - Ligji për leje dhe licenca.

Projektligji i propozuar është ndryshuar mbi 40% dhe i plotëson kushtet për tu proceduar si projektligj i ri në përputhje me Udhëzimin për standardet e hartimit të akteve juridike.

Me hartimin e këtij projektligji ne synojmë të jemi shembull dhe model në rajon dhe më gjerë. Projektligji është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren 09/2011, për punën e Qeverisë së Kosovës dhe është pranuar Deklarata financiare nga

Ministria e Financave dhe Deklarata e pajtueshmërisë me legjislacionin e Bashkimit Evropian nga Ministria e Integritetit Evropian.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji në fushën e ekonomisë dhe të sigurisë kombëtare, si dhe interesat e politikës së jashtme të Republikës së Kosovës, deputetë të nderuar, pas diskutimit ju ftoj që ta miratoni. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Komisionit, fjalën e ka kryetari Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Zonja ministre,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e datës 4 qershor shqyrtoi në parim këtë projektligj dhe Komisioni konsideron që projektligji përmbushë ose i plotëson kushtet e parapara me Rregulloren e punës së Kuvendit.

Po ashtu, është konsideruar që janë përfshirë në punën, në këtë draft të sjell disa prej rekomandimeve ose direktivave të BE-së, si rekomandime që vijnë edhe nga Raporti i Progresit. Komisioni konsideron që Kuvendi duhet ta miratojë në parim këtë projektligj dhe të procedohet pastaj e të kontribuohet në grupet punuese për ta përmbyllë sa më shpejt. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje ministre!

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar me vëmendje Projektligjin për tregtinë e mallrave strategjike dhe e mbështet në parim.

Më lejoni, që të ritheksoj edhe njëherë atë që e tha ministrja, se qëllimi kryesor i ndryshimit të Ligjit për tregti me mallra strategjike është harmonizimi me legjislaturën e BE-së.

Me këtë projektligj rregullohet eksporti, importi, transiti, transngarkimi, rieksperti dhe ritransferimi i mallrave strategjike. Ky projektligj është në të mirë të avancimit të sigurisë kombëtare dhe të interesave të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës.

Po ashtu ky projektligj është për të plotësuar marrëveshjet dhe zotimet ndërkombëtare lidhur me mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, si dhe mallrave tjera strategjike për qëllime ushtarake dhe për të kontribuar në angazhimet regjionale dhe ndërkombëtare të menaxhimit të tregtimit me mallra strategjike.

Plotësimi e ndryshimi i ligjit në fuqi ka hapur mundësinë që ky projektligj të bëjë definimin e saktë të përgjegjësiave dhe ndarjen e kompetencave për institucionet dhe subjektet të cilat e formojnë sistemin e kontrollit të eksportit, përkatësisht kontrollin strategjik të tregut në Republikën e Kosovës.

Ne si grup parlamentar gjatë analizimit kemi edhe vërejtjet tona, të cilat do t'i japim gjatë fazës së amendamentimit në Komisionin Funkcional. E mbështesim në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, deputetja Teuta Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Në Grupin Parlamentar të LDK-së është pritur dhe është analizuar Projektligji për mallrat strategjike dhe mendoj që me këtë ligj do të rregullohen gjërat të cilat në të kaluarën kanë mbetur të parregulluara.

Është me rëndësi të thuhet që ky ligj ka të bëjë domethënë me tri fusha të rëndësishme, të cilat do t'i rregullojë:

- Është fushëveprimtaria e kontrollit, ku do të ketë një vëmendje të veçantë për sigurinë e Kosovës,
- Fusha e dytë është zbatimi, në të cilën flitet për dënime dhe për sanksione për mospërmbylljen e obligimeve, dhe
- Pjesa e tretë ka të bëjë me qasjen industriale, apo industrial outrich, ku flitet për rregullat e brendshme për këto lloje të mallrave strategjike.

Mendoj që ligji i vjetër i cili ka pasur probleme, sidomos kur ka të bëjë me transaksionet të cilat nuk iu kanë nënshtruar këtij ligji dhe kanë mbetur të pambuluara në të kaluarën. Një pjesë e veçantë e këtij ligji ka të bëjë edhe me broker apo me persona kosovarë, të cilët kanë të bëjnë me mallin edhe në raste kur malli strategjik nuk mbërrin fare në territorin e Kosovës, por përmes një njeriu i cili i negocion apo një personi juridik negociohet blerja dhe shpërndarja e mallit në vendet tjera.

Dhe, ky ligj i ri tashmë e rregullon edhe këtë fushëveprim, i cili në të kaluarën ka qenë i pambuluar.

Kjo ka të bëjë edhe me shtetas të huaj, të cilët mund të kenë, të veprojnë nga Kosova dhe mendoj që me këtë rritet edhe siguria e shtetit të Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Është me rëndësi të shtohet që edhe transiti edhe transporti duhet të jenë në veprim të këtij ligji dhe i nënshtrohen licencimit, gjë e cila tregon edhe një kontroll për mallra të rëndësishëm, mallra strategjik.

Është shpjeguar qartë kur këto mallra rregullohen me këtë ligj dhe gjithashtu ashtu është me rëndësi që ky ligj e bën ndarjen e mallrave strategjike të cilët kontrollohen nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe mallrat të cilat i mbulon ky ligj.

Mendoj që shkurtimisht nuk do të zgjasë më tepër, por është ligj i cili është i nevojshëm që të mbulojë kontrollin dhe rregullimin e kësaj fushëveprimtarie dhe ne deputetët e Grupit Parlamentar të LDK-së në këtë Komision mendoj që ato vërejtje të cilat tashmë i kemi do të tentojmë që t'i parashtrojmë në Komisionin FunkSIONAL dhe të ndihmojmë në pasurimin e këtij ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, kryetari i Grupit Parlamentar, Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta votojë në parim këtë ligj.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Aleancës, deputeti Ramiz Kelmendi e ka fjalën.

RAMIZ KELMENDI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do ta votojë këtë ligj.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani e ka fjalën,

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për ministren dhe deputetët.

Duke marrë parasysh se në mandatin e kaluar ne e kemi miratuar Projektligjin për tregtinë e mallrave strategjike diku në fund të vitit 2010, mund të themi se në atë kohë Komisioni parlamentar pati amendamentuar projektligjin, mirëpo jo me arsye që ka qenë projektligji shumë i mirë. Arsyeja e vetme ka qenë që ne të kemi një ligj për tregti të mallrave strategjike. Dhe gjatë punës së implementimit të këtij ligji është parë që ky ligj nuk mund të zbatohet edhe në bazë të direktivave të BE-së dhe në bazë të mundësive që i ka pasur projektligji i kaluar.

Nëse e shohim ligjin e tashëm dhe ministrja tregoi se është bërë plotësim-ndryshimi diku i 40% të ligjit, mirëpo në efekt mund të themi se në këtë projektligj i cili është sjell sot në Kuvend të Kosovës, mund të themi se janë nenet e projektligjit më të qartësuara dhe është më lehtë për zbatueshmëri duke marrë parasysh se Ligji për tregtinë e mallrave strategjike apo më mirë të themi Ligj për menaxhimin e mallrave strategjike, se të njëjtin kuptim e ka, mund të themi se është ligj shumë i rëndësishëm për Republikën e Kosovës duke marrë parasysh se edhe në mandatin e kaluar kur është miratuar ne e kemi miratuar me gjithë presionin që është bërë nga Ministria e Punëve të Brendshme, që Kosova të pajiset me një infrastrukturë ligjore për arsye të sigurisë së saj si shtet i ri.

Në rast se e shohim fushë veprimtarinë e ligjit dhe mundësitë se si do të zbatohet ky ligj nga Qeveria, ekskluzivisht nga Ministria e Tregtisë dhe Ministria e FSK-së, Doganat do të jetë një projektligj apo një ligj i cili do t'i atakojë shumë dikastere për arsye se çështja e zbatueshmërisë së këtij ligji kërkon që ligji të ketë....

(Polemikë)

Mesa po shihet nuk është i interesuar kurrkush për ligjet për Kosovën, janë të interesuar të bëjnë muhabet, Zoti na ruajt!

Shihet se Projektligji është i rëndësisë së veçantë, mirëpo deputetët nuk po e shohin projektligjin si të rëndësisë së veçantë. Koalicioni për Kosovë të Re i jep përkrahje Projektligjit dhe besojmë që në miratimin e plotë të këtij projektligji pas Komisionit parlamentar do të kemi një ligj i cili do të jetë shembull për vendet e BE-së. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të SLS, nuk e ka kërkuar fjalën kurrkush. Në emër të Grupit “6+”, kryetarja Mufera Shinik, e ka fjalën.

MUFERA SHINIK: Faleminderit, kryetar!

6 + Parlamenter Grubu da görüşülen Yasa Tasarısını prensipte kabul etmektedir. Komisyonunda önerilerimizi sunarak desteklemekteyiz. Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit të ri “Zajednička Budućnost”, deputeti Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče!

Poslanička grupa Zajednička budućnost je pažljivo analizirala Nacrt zakona, koji uređuje uvoz-izvoz strateških roba i ovim zakonom i njegovim usvajanjem možemo na najbolji način kontrolisati uvoz i izvoz, kao i tranziciju roba opasnih i na taj način povećati će se sigurnost države i naroda.

Poslanička grupa Zajednička budućnost podržaće u načelu usvajanje ovog zakona i preko funkcionalnih komisija dati svoj doprinos na njegovom daljem radu i usvajanju. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit Goran! Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: I nderuari kryetar,

E nderuara ministre,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Më lejoni që lidhur me Projektligjin për tregti dhe mallra strategjike të paraqes disa vërejtje e komente konkrete.

Pikësëpari, në nenin 4 të këtij drafti, me të cilin pretendohet të rregullohet struktura dhe kompetenca e Komisionit për tregtinë e mallrave strategjike, mendoj se ekzistojnë disa zbrazësi në të, për arsye se me dispozitat e këtij neni përcaktohet struktura dhe mënyra e emërimit të anëtarëve të Komisionit, mirëpo nuk përcaktohet fare se çfarë kriteresh shkollimi, përvojë profesionale duhet të posedojë një person për t’u emëruar në këtë Komision.

Duke pasur parasysh se ky është njëri prej komisioneve kryesore që kryen një numër të madh të detyrave të përcaktuara me këtë ligj, mendoj se mirë është që me ligj e jo me akt nën-ligjor të përcaktohen kriteret e lart theksuara, si dhe mandati apo periudha kohore sa

mund të jetë një person anëtar i këtij Komisioni, eventualisht për sa kohë mund të riemërohen këta persona.

Më tutje, në nenin 10, me të cilin përcaktohen llojet e licencave që mund të lëshohen në Republikën e Kosovës për eksport, import, transit e tjera, me mallra strategjike, theksohen tri lloje të licencave dhe atë:

- Licenca individuale,
- Licenca globale, dhe
- Licencat e përgjithshme.

Kurse, me paragrafin 1.3 të këtij neni jepen sqarime vetëm për lëshimin dhe përdorimin e licencës së përgjithshme, por jo edhe për dy llojet tjera të licencave, respektivisht atë individuale dhe globale, që do të thotë se nga leximi dhe analizimi i këtij drafti zbatuesi i ligjit, por as lexuesi tjetër, nuk mund ta ketë të qartë se çka janë këto dy licenca dhe ku qëndron dallimi sidomos ndërmjet licencës globale dhe asaj të përgjithshme.

Andaj, propozoj që në kuadër të nenit 10 të shtohen edhe paragrafë të caktuar me të cilët do të jepeshin sqarime të nevojshme për secilin lloj të licencave.

Pastaj, në nenin 11, paragrafi 1, me të cilin rregullohet aplikimi për licencë, ndër të tjera, thuhet se: Nëse kërkesa është e pakompletuar apo e pasaktë, Ministria mund të kërkojë prej aplikuesit që ta kompletojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar nga Ministria; që nënkupton se pas aprovimit të këtij ligji, Ministria duhet të nxjerrë një akt nënligjor me të cilin do të përcaktojë afatin shtesë për kompletimin e kërkesës, kurse unë vlerësoj se mirë është që me dispozitat e këtij ligji të përcaktohet një afat i arsyeshëm, diku prej 8 deri 15 ditë, që do të ishte kohë e mjaftueshme për kompletimin e dokumentacionit.

Kurse në paragrafin 4 të nenit 13, me të cilin përcaktohet procedura e lëshimit të licencës, ndër të tjera thuhet: Në rastet kur Komisioni e refuzon kërkesën për licencë, paraqitësi i kërkesës do të kërkojë rishqyrtimin administrativ nga Komisioni brenda afatit prej 30 ditëve; që në esencë po i bie që edhe rishqyrtimi i kërkesës të bëhet nga Komisioni i njëjtë, gjë që zbatimi praktik i kësaj dispozite duket paksa i palogjikshëm, sepse nëse anëtarët e Komisionit janë parimorë, atëherë sigurisht nuk do të ketë ndryshim në vendimin e marrë me rastin e shqyrtimit.

Prandaj, propozoj që në këtë ligj të përcaktohet një procedurë apo mekanizëm i tillë, sipas të cilit shqyrtimi dhe rishqyrtimi i kërkesës nuk do të bëhej nga organi dhe personat e njëjtë, por nga dy trupa të ndryshëm.

Më tutje, në nenin 16 theksohet se në rast të dyshimit të arsyeshëm mbi vërtetësinë dhe vlefshmërinë ligjore të dokumentacionit të dorëzuar, atëherë Ministria të njëjtin ia përcjell autoriteteve kompetente.

Vërejtja ime ka të bëjë me shprehjen “autoritete kompetente”, sepse si e tillë është mjaft e papërcaktuar andaj, mendoj se mirë është që me qëllim të zvogëlimit të interpretimeve të ndryshme, pasi që jemi në fazën e draftimit dhe aprovimit të këtij ligji, duhet që në këtë

nen të përcaktohet se kush janë autoritetet kompetente: Policia, Prokuroria, Gjykata apo dikush tjetër, ashtu që Ministria saktësisht të dijë se kujt do t'i drejtohet.

Vërejtja e njëjtë mund të thuhet edhe për nenin 25 paragrafi 6 të këtij drafti.

Komenti tjetër ka të bëjë me nenin 27 në paragrafin 1 të i cili theksohet se Ministria në bazë të vendimit të Komisionit e anulon apo e revokon licencën; kurse në nenin 4 të paragrafit 4 të këtij draftligji, decidivisht thuhet: Komisioni aprovon, anulon, ndryshon dhe revokon licencën.

Kështu, si janë të rregulluara çështjet e anulimit dhe revokimit të licencave, paksa janë kundërthënëse.

Andaj, propozoj që gjatë punimit në këtë draft të bëhet një harmonizim ndërmjet dispozitave të nenit 4 pika 4 dhe të nenit 27, sepse vendimin për anulimin dhe revokimin e licencave ose mund ta marrë Komisioni ose ministria.

Komenti im i fundit për këtë draftligj ka të bëjë me nenin 29, me të cilin rregullohen sanksionet penale të cilat parashihen për shkeljen e dispozitave të këtij ligji, ku ndër të tjera thuhet: kushdo që me qëllim shkelë dispozitat e këtij ligji, duke shkaktuar dëme dhe pasoja për sigurinë e shtetit, politikën e jashtme apo sigurinë publike, dënohet me burgim prej 1 deri 10 vjet ose me gjobë deri në 30.000 euro.

Sugjerimi i parë është që të hiqet shprehja “me qëllim”, sepse edhe nëse veprimi kryhet nga pakujdesia, personi që i shkakton pasojat e tilla, duhet të sanksionohet.

Dhe, sugjerimi tjetër ka të bëjë me llojin dhe lartësinë e sanksioneve. Kështu siç është paraparë, personi mund të dënohet ose me burg ose me të holla, gjë që ia lë në vullnetin e gjykatës që të përcaktohet se cilin dënim do t'ia shqiptojë. Madje, te dënimi me të holla parashihet vetëm limiti i lartë 30.000 euro, por jo edhe limiti i ulët, që realisht shikuar, edhe nëse gjykata i shqipton dënim me të holla prej 50 deri 100 euro, ai e ka zbatuar ligjin.

Andaj, propozoj që ky nen apo çështja e sanksioneve penale të rishqyrtohet me kujdes dhe të specifikohen sanksionet për veprimet dhe pasojat e caktuara, e jo të mbetet kështu siç është, në mënyrë të përgjithësuar dhe t'i lihet mundësia që gjykata për veprim të caktuar të shqiptojë dënimin prej 50 deri 100 euro dhe deri me dënimin prej 10 vjet burg. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk kemi tjerë të lajmëruar për diskutim, dhe ministrja nuk është e interesuar të flasë, sepse e keni mbështetur Projektligjin. Atëherë, shkojmë në procedurën e votimit.

Prezenca fizike është 62 deputetë. Prania elektronike 84.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Atëherë, me 60 në formë elektronike, 1 me ngritje dore - 61, kundër dhe abstenim nuk ka, konstatohet se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për tregtinë e mallrave strategjike.

Ngarkohet Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Pasi jemi me numër të mjaftueshëm, shkojmë në miratimin e procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur më 31 maj 2013.

A ka kush kundër? Nuk ka.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 31 maj 2013.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produktet e ndërtimit

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për produktet e ndërtimit dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Për këtë projektligj janë propozuar 35 amendamente të propozuara nga Komisioni Funksional.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Të pranishëm 63 deputetë.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 27

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 28

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 29

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 30

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 31

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 32

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 33

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 34

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 35

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Tani votojmë ligjin në tërësi, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim elektronik, votojmë tash.

Konstatohet se me 61 vota për, Kuvendi miratoi Ligjin numër 04/L-181 për produktet e ndërtimit.

6. Zgjedhja e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimin për miratim.

E ftoj kryetaren e Komisionit ad hoc, Xhevahire Izmaku, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë rekomandimin. Deputete, e ke fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

E nderuar ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, pas intervistimit të kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media i propozon Kuvendit emërimin e një anëtari të KPM-së.

Anëtarët e KPM-së emërohen nga Kuvendi i Kosovës në bazë të nenit 13, të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media.

Mandati i anëtarëve i KPM-së caktohet me short. Dy anëtarë me mandat dy vjeçar, tre anëtarë me mandat trevjeçar dhe dy anëtarë me mandatë katërvjeçar.

Në bazë të shortit i cili është vënë me datën 30 gusht të vitit 2012, në këtë radhë zgjedhim një kandidat i cili do të ketë mandatin tre vjeçar.

Pra, ne i kemi dy kandidatë dhe do të votojmë për Drita Lulaj- Berisha ose Ilmi Halilin. Kaq. Faleminderit!

KRYETARI: Shkojmë me formimin e Komisionit zgjedhor. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, kë e propozon? Deputeti Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Në emër të Grupit të Partisë Demokratike, propozojmë Behar Selimin.

KRYETARI: Lidhja Demokratike, kryetari Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Ne propozojmë Afërdita Berisha-Shaqiri.

KRYETARI: Faleminderit!

Nga “Vetëvendosja”, kryetari Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Ne propozojmë deputetin Afrim Hoti.

KRYETARI: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën. Propozon Ramiz Kelmendin. Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Prej Koalicionit për Kosovë të Re, propozohet deputeti Jeton Sfirca. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga SLS-ja, kryetari Sasha, e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!
SLS predlaži Jasminu Živković.

KRYETARI: Faleminderit! “6+”, Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Grupi Parlamentar “6+”, propozon deputetin Duda Balje.

KRYETARI: Faleminderit! Dhe nga Grupi Zajednička budućnost, Goran Marinković, e ka fjalën kryetari Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče!
Milivoje Stojanovića, predlažem.

KRYETARI: Lus deputetët e nominuar për anëtarë të Komisionit le t’i zënë vendet e tyre:

Adem Grabovci, Afërdita Shaqiri-Berisha, Afrim Hoti, Afrim Kasolli, Gëzim Kelmendi, Agim Kuleta, Ahmet Isufi, Albana Fetoshi, Albana Gashi, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Albert Kinolli, Alma Lama, Anton Çuni; Arben Gashi, Ardian Gjini, Armend Zemaj; Aurora Bakalli, Azem Syla, Bahri Thaçi; Arsim Bajrami, Bali Muharremaj, Berat Buzhala; Behar Selimi, Amir Ahmeti, Bekim Haxhiu; Biserka Kostiq, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra; Burim Ramadani, Danush Ademi, Daut Haradinaj; Donika Kadaj-Bujupi, Duda Balje, Elmi Reçica; Emilija Rexhepi, Enis Kervan, Nait Hasani; Eqrem Kryeziu, Etem Arifi, Fadil Demaku; Fatmir Limaj, Fatmir Xhelili, Jeton Svirca; Flora Brovina, Florin Krasniqi, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca; Goran Marinković, Nijazi Idrizi, Haki Demolli; Halit Krasniqi, Hamza Balje, Hydajet Hyseni; Hashim Deshishku, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami; Emin Gërbeshi, Idriz Vehapi; Imri Ahmeti, Ismet Beqiri, Jakup Krasniqi; Jasmina Zhivković; Jelena Bontiq, Justina Pula; Kymete Bajraktari, Latif Gashi; Liburn Aliu, Lirije Kajtazi; Lumnije Morina; Lutfi Haziri, Lutfi Zharku, Fikrim Damka; Kurtan Kajtazi, Suzan Novobërdaliu, Mufera Shinik; Muhamet Mustafa, Mursel Halili, Myzejene Selmani; Naser Osmani, Nazane Breca, Kymete Bytyçi; Sasha Milosavljeviq, Petar Miletqi, Rada Trajković; Ramë Vataj, Ramiz Kelmendi; Ramiz Lladrovci, Rasim Demiri, Rexhep Selimi, Rita Hajzeraj-Beqaj; Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala; Sali Asllanaj, Salih Morina, Salihe Mustafa; Sasha Gjokiq, Milivoje Stojanović; Sevdije Lama; Shaip Muja; Skënder Hyseni, Boban Todorović, Sreten Ivanović, Teuta Sahatqija; Teuta Haxhiu, Time Kadrijaj, Ukë Rugova; Vesimir Saviq, Vesna Mikiq, Visar Ymeri; Vjollca Krasniqi, Vjosa Osmani; Valbona Dibra, Xhevahire Izmaqu; Xhevdet Neziraj, Zenun Pajaziti;
(Ndërrprerje e incizimit)

KRYETARI: Fjalën e ka kryetarja e Komisionit Zgjedhor, Afërdita Berisha-Shaqiri.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI:

Drita Lulaj-Berisha, Ilmi Alili, E pavlefshme, E pavlefshme, Ilmi Alili, Drita Lulaj-Berisha, E Pavlefshme, Ilmi Alili, E pavlefshme, E pavlefshme, Drita Lulaj-Berisha, Ilmi Alili, E pavlefshme, Drita Lulaj Berisha, E pavlefshme, Ilmi Alili, Ilmi Alili, E pavlefshme, Ilmi Alili, E pavlefshme, Drita Lulaj-Berisha, Drita Lulaj-Berisha, Drita Lulaj-Berisha, Drita Lulaj- Berisha, Ilmi Alili, Drita Lulaj-Berisha, E pavlefshme, E pavlefshme, E pavlefshme, Drita Lulaj-Berisha, E pavlefshme, E pavlefshme, E pavlefshme, Ilmi Alili, E pavlefshme, Drita Lulaj-Berisha, Ilmi Alili, Drita Lulaj-Berisha, E pavlefshme, Ilmi Alili, E pavlefshme, Ilmi Alili, E pavlefshme, E pavlefshme, Drita Lulaj-Berisha, E pavlefshme, E pavlefshme, Ilmi Alili, Ilmi Alili, Drita Lulaj-Berisha, Ilmi Alili, E pavlefshme, Ilmi Alili, Drita Lulaj- Berisha, E pavlefshme, E pavlefshme, E pavlefshme, Ilmi Alili, E pavlefshme, Ilmi Alili, E pavlefshme, Ilmi Alili, Drita Lulaj-Berisha, Ilmi Alili, E pavlefshme, E pavlefshme, E pavlefshme, E pavlefshme, Ilmi Alili, Drita Lulaj-Berisha, Ilmi Alili, E pavlefshme dhe Drita Lulaj- Berisha.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Urdhëro! Fjalën e ka kryetarja e komisionit zgjedhor, deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Komisioni votues, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit, për zgjedhjen e një anëtar i Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, në mbledhjen plenare të mbajtur më 13 qershor 2013, konstaton:

Në votim kanë marrë pjesë 71 deputetë. Të pavlefshme janë 32 fletëvotime. Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë si në vijim:

- Drita Lulaj- Berisha, ka fituar 18 vota;
- Ilmi Alili, ka fituar 21 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 të Ligjit numër 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se asnjëri nga kandidatët nuk ka marrë vota të nevojshme për t'u zgjedhur anëtar i Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media.

Konkursi duhet të përsëritet.

KRYETARI: Do të thotë këtu e përfundojmë seancën. Mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*